

Për: Komisioni i Pavarur për Media (“KPM”)

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

Nga: IPKO Telecommunications LLC

Lënda: Komentet e IPKO Telecommunications mbi projekt Rregulloren për Shpërndarjen e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale dhe shërbimet Radio Mediale nëpërmjet operatorëve të rrjetit

Data: 30 prill 2013

Të nderuar anëtarë të KPM-së,

Ju lutem gjeni më poshtë komentet e IPKO-s mbi projekt Rregulloren për Shpërndarjen e Shërbimeve Mediale Audio-Vizuale dhe Shërbimet Radio Mediale nëpërmjet operatorëve të rrjetit.

IPKO shpreh gatishmërinë për tu takuar në mënyrë individuale për të diskutuar komentet e dhëna në këtë dokument. Për më tepër, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj projekt Rregulloreje, ne presim nga KPM të ndajë me të gjithë palët e interesuara komentet e ofruara nga të gjithë prej tyre dhe të organizojë dëgjim publik para miratimit të versionit përfundimtar të së njëjtës.

## **Komentet mbi nenet përkatëse**

### **NENI 1 – QËLLIMI**

Parashikon si më poshtë:

*“Qëllimi i kësaj Rregulloreje është sigurimi i qasjes në shërbimet e komunikimit për të gjithë përdoruesit në baza transparente, objektive dhe jo-diskriminuese ....”*

Shprehja shërbimet e komunikimit është shumë e gjerë për rregullim nga kjo draft Rregullore, pasi që përfshin një gamë të gjerë të shërbimeve, përveç shërbimeve audio-vizuale mediale të cilat kjo draft Rregullore në të vërtetë synon të rregullojë. Kjo përfshin shërbimet e komunikimit mobil, internet, telefoni fikse dhe shërbime të tjera. Prandaj, IPKO propozon ndryshimin e mëposhtëm të këtij neni:

*“Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë qasje në shërbimet mediale audio-vizuale për të gjithë përdoruesit në baza transparente, objektive dhe jo-diskriminuese ....”*

### **NENI 3 PËRKUFIZIMET:**

#### **Operatori i rrjetit**

Në mënyrë që të jetë e qartë se çfarë do të thotë ky përkufizim, IPKO propozon për të shtuar kategoritë e operatorëve të rrjetit që kjo Projekt Rregullore ka për qëllim të rregullojë. Përveç kësaj, përkufizimi duhet ta bëjë të qartë se operatorët e rrjetit nuk kanë asnjë përgjegjësi redaktuese në kanalet që ritransmetohen nëpërmjet rrjeteve të tyre.

Prandaj, IPKO propozon për të shtuar fjalinë e mëposhtme në fund të përkufizimit: *“Operatorët e rrjetit përfshijnë ofruesit e televizionit kabllor, ofruesit e TV satelitor, ofruesit e shërbimeve IPTV, etj. Operatorët e rrjetit nuk kanë asnjë përgjegjësi redaktuese për kanalet që ritransmetohen nëpërmjet rrjeteve të tyre”.*

#### **TV i hapur (Free TV)**

Projekt rregullorja parashikon përkufizimin e TV të lirë edhe pse ky përkufizim nuk është përdorur në tekstin e kësaj projekt Rregulloreje. Prandaj, ne nuk shohim arsyen e këtij

përkufizimi. Gjatë miratimit të versionit përfundimtar të kësaj projekt Rregulloreje, KPM duhet të sigurojë se nuk ka asnjë dykuptimësi të lënë në përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore, pasi që përkufizimi i kësaj shprehje çon për të kuptuar se operatorët e caktuar të rrjetit ose paketa të caktuara do të konsiderohen si TV e lirë, dhe kjo nuk mund të jetë e pranueshme, pasi që operatorët e rrjetit si të tillë nuk mund të ofrojnë shërbime të TV të hapur (free TV).

Është e rëndësishme të theksohet se direktiva e BE-së askund nuk përcakton llojet e TV të hapur, si dhe platformat përmes të cilave ato do të transmetohen. Përkufizimi i tillë sipas kësaj projekt Rregulloreje është me paragjykim drejt operatorëve të rrjetit dhe mund të jashtëzakonisht të ndikojë mbi barrën e madhe që operatorët do të kenë në rrjedhën e tyre të biznesit. Sidomos, kur praktika me KPM-në ka treguar se KPM-ja ka konsideruar Pakon Familjare të IPKO-s si një paketë e TV të lirë dhe nuk ka lejuar transmetimin e ngjarjeve sportive të blera për TV me pagesë (pay tv). Kjo ka çuar në një vendim të paligjshëm të KPM-së, me të cilin IPKO ishte sanksionuar në mënyrë arbitrare dhe pa asnjë bazë ligjore me gjobë prej 40 mijë euro.

Duhet të kemi në konsideratë se operatorët kanë shpenzimet e krijimit si dhe mirëmbajtjes së platformës dhe një përkufizim i tillë paragjykues i free TV me siguri do të shkaktojë paqartësi për ofruesit e shërbimeve mediale si dhe përdoruesit e shërbimeve të televizionit digjital, të cilët mund të kërkojnë që televizionet Free TV të shihen tek Operatorët e Rrjetit, edhe në qoftë se përdoruesit nuk do të paguajnë tarifën mujore për ofrimin e shërbimeve të operatorëve.

Prandaj, bazuar në faktet e mësipërme, kjo projekt Rregullore duhet qartazi të vendos parimet e mëposhtme:

- Operatorët e rrjetit (kabllo) janë platforma televizive me pagesë (pay tv), e cila është një shërbim në të cilin parapaguesi mund të ketë qasje pas nënshkrimit të marrëveshjes për shfrytëzimin e shërbimit të TV digjital, dhe pas pagesës së një çmimi të caktuar mujor për shërbim të tillë.
- Metodatat në të cilat operatorët e rrjetit vendosin të organizojnë paketën e tyre për të ofruar shërbimin e televizionit të rrjetit janë përgjegjësi e vetme e operatorit të rrjetit. KPM-ja nuk mund ta konsiderojë ndonjëherë prej paketave të operatorëve të rrjetit si një paketë të TV të lirë, dhe të imponojë/kërkojë detyrime shtesë nga operatorët e rrjetit. Operatori i rrjetit ka autorizim të vetëm për të organizuar programet të cilat i ka blerë, bazuar në objektivat e tij të biznesit.

Për më tepër, përkufizimi i TV të hapur (free TV) duhet të jetë i harmonizuar me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediale Audio Vizuale 2010/13/EU për

të sqaruar se “televizioni i hapur” nënkupton transmetimin në një kanal, qoftë publik apo komercial, të programeve të cilat janë të qasshme për publikun, pa pagesë”.

### **Ofruesi i shërbimeve programore përmes një operatori të rrjetit**

Të zëvendësohet shprehja “Ofruesi i shërbimeve programore përmes një operatori të rrjetit”, me shprehjen “ofruesi i shërbimit medial” të cilat duhet të përcaktohen si në Ligjin për KPM-në: “një person fizik ose juridik me përgjegjësi editoriale për përzgjedhjen e përmbajtjes audio-vizuale të ofruesit të shërbimit medial dhe vendosja e mënyrës së organizimit të tij”. Dhe pastaj, të sqarohet se ekzistojnë dy lloje të ofruesve të shërbimeve mediale, TV kabllor, të cilat janë themeluar për transmetim vetëm nëpërmjet operatorit të rrjetit, dhe transmetuesit, të cilat përdorin frekuencat në mënyrë që të pranohen/shihen nga përdoruesit.

### **Bartja e detyrueshme**

Teksti origjinal në projekt rregulloren: “është një detyrim me të cilin operatorët e rrjetit obligohen të bartin përmbajtje të caktuara të cilat plotësojnë kërkesat e caktuara”

Përkufizimi si i tillë është shumë i paqartë dhe nuk korrespondon me detyrimet që rrjedhin nga neni 12 i projekt Rregullores. Prandaj, IPKO kërkon që ky përkufizim të ri-hartohet në mënyrë që të jetë në përputhje me Direktivën e BE-së mbi Shërbimet Universale (2002/22/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për shërbimet universale dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike), konkretisht me nenin 31 të saj, i cili në mënyrë eksplicite thekson se obligimi për bartje të detyrueshme i nënshtrohet pagesës nga transmetuesit tokësor, e cila pagesë duhet të jetë proporcionale dhe transparente.

### **Përgjegjësia redaktuese**

IPKO propozon për të shtuar përkufizimin e Përgjegjësisë redaktuese si vijon - *ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe mbi organizimin e tyre ose në një renditje kronologjike, në rastin e transmetimeve televizive ose radio. Operatorët e rrjetit nuk do të kenë përgjegjësi redaktuese për kanalet që ritransmetohen nëpërmjet platformave të tyre.*

## NENI 5 - KOHËZGJATJA DHE RIPËRTRIRJA E LICENCËS

**Pika 4** është shumë e paqartë. Versioni shqip nuk ka asnjë kuptim. Ekziston nevoja ose për të qartësuar ose për të shlyer këtë paragraf të tërë.

## NENI 6 - E DREJTA E SHPËRNDARJES

**Paragrafi 1 parasheh:** *“Para përfshirjes së ndonjë shërbimi medial audio-vizual apo një shërbimi radio medial në një pako të shërbimit, i licencuari është i obliguar të marrë pëlqimin me shkrim nga pronarët e përmbajtjes së programit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar dhe nuk duhet të nis shpërndarjen e shërbimeve të tilla para se t’i merr pëlqimet”.*

KPM-ja mund vetëm të qeverisë të drejtat e transmetimit, që do të thotë se duhet të kontrollojë rregullisht nëse operatorët e rrjetit të kanë marrëveshje të vlefshme për shpërndarjen e përmbajtjes nëpërmjet platformës së tyre. Ndërkaq, marrëveshjet me autorët që kanë krijuar përmbajtje të tillë, kjo pjesë bie nën Ligjit për të drejtat e autorit në Kosovë, i cili parasheh administrim kolektiv të drejtave të tilla. Kjo do të thotë se operatorët e rrjetit duhet të negociojnë me shoqëritë kolektive për të drejtat e tilla, dhe negociatat e tilla nuk bien nën autoritetin e KPM-së, pasi që Ligji mbi të drejtat e autorit nuk e përcakton KPM-në si mbrojtës të drejtave të tilla. Prandaj, IPKO propozon ndryshimin e Nenit 6.1 si vijon:

*“Para përfshirjes së një shërbimi medial audio vizual apo një shërbim radio medial në një pako të shërbimit, operatori i rrjetit detyrohet të arrijë marrëveshje me shkrim me secilin ofrues të shërbimit medial për shpërndarjen e ofruesit të tillë dhe nuk duhet të fillojë me shpërndarjen e shërbimeve të tilla para marrjes së pëlqimit të tillë.”*

**Paragrafi 3** thotë se *“I licencuari është i detyruar ta informojë KPM-në për çdo ndryshim në listën e programeve shtatë (7) ditë para futjes së ndryshimit të planifikuar”.*

Operatorët e rrjetit nuk duhet të detyrohen të informojnë KPM-në për cilindo lloj ndryshimi në listën e kanaleve, pasi që kjo do të krijojë një barrë të madhe për operatorët e rrjetit, duke pasur parasysh se platforma kabllore është një platformë shumë dinamike dhe ka ndryshime të vazhdueshme. Operatori i rrjetit duhet të përpiqet për të informuar përdoruesit e tij sa më shpejt të jetë e mundur, pasi që ata do të jenë të prekur nga një ndryshim i tillë, kurse KPM-ja duhet të informohet vetëm për ndryshime të mëdha në listën e programeve, respektivisht, kur shtohet apo largohet ndonjë ofrues i shërbimit audio-vizual. Kjo ka qenë praktika deri më tani në mes të operatorëve kabllor dhe KPM-së dhe është treguar të jetë shumë efektive. Gjithashtu është e rëndësishme të theksojmë se a kemi të bëjmë me ditë pune ose ditë kalendarike. Prandaj, IPKO propozon tekstin e mëposhtëm për të njëjtin paragraf:

*“Operatori i rrjetit duhet të njoftojë KPM-në për ndonjë ndryshim të madh në listën e programeve, përkatësisht në drejtim të shtimit ose largimit të shërbimeve të reja audio-vizuale dhe radio, shtatë (7) ditë pune para realizimit të ndryshimeve të tilla.*

## **Neni 7 – TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E OPERATORËVE TË RRJETIT**

Paragrafi 4 i tekstit origjinal të projekt Rregullores parasheh

*“Operatori i rrjetit, gjatë ofrimit të shërbimit medial audio-vizual, duhet të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren e KPM-së për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve nga Përmbajtjet e Dëmshme Programore duke:*

*Koduar të gjitha kanalet që kanë përmbajtje në kundërshtim me këtë rregullore (rregullorja për mbrojtjen e të miturve) në mënyrë që parapaguesit/përdoruesit të kenë mundësinë që të dekodojnë çdo kanal, sipas dëshirës së tyre; apo*

*5. Duke ofruar një mekanizëm dhe udhëzime të qarta në mënyrë që parapaguesit do të mund të dekodojnë secilin kanal që ata dëshirojnë. Operatorët e rrjetit, të cilët zgjedhin këtë opsion, duhet të përfshijnë paralajmërimet e duhura së bashku me udhëzimet për dekodim të atyre kanaleve duke iu bërë me dije parapaguesve se origjina e këtyre kanaleve është jashtë Kosovës, dhe se nuk mund të jenë në pajtueshmëri me Rregulloren e KPM-së për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore, dhe se prindërit/kujdestarët janë përgjegjës për dekodimin e atyre kanaleve në mënyrë që të mbrojnë fëmijët e tyre.”*

KPM-ja duhet të informohet se kodimi mundësohet për kanal dhe jo për periudhë të caktuar kohe ose program brenda një kanali. IPKO tashmë ka koduar një numër të kanaleve që janë në shkelje të Rregullores së KPM-së për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve, dhe pasi që nuk ka përgjegjësi redaktuese për programin që është duke u transmetuar, duhet të udhëzohet nga ana e KPM-së se cilat kanale të tjera IPKO duhet të kodojë, në mënyrë që të jetë në përputhje të plotë me Rregulloren e njëjtë.

Neni i njëjtë duhet të përfshijë të drejtat e mëposhtme për operatorët e rrjetit:

- Paguesa e një tarifë për lidhjen fillestare, një tarifë mujore për linjën e parapagimit (abonimi), si dhe të gjitha tarifat e tjera të përcaktuara në listën e çmimeve;*
- Të ngarkohet parapaguesi me tarifë për lidhje shtesë të një linjë të shkyçur të parapaguesit, për shkak të pagesës së vonuar ose mos-pagesës së faturës, dhe krahas shumës që detyrohet, të paguajë një tarifë shtesë për lidhjen e linjës parapaguese, në përputhje me listën e çmimeve;*

- Të kontrollohet aftësia paguese e personit juridik apo fizik që paraqet kërkesën për lidhjen e një marrëveshjeje të parapagimit;
- Ndryshimi i karakteristikave teknike të rrjetit dhe të shërbimit, duke përfshirë edhe ndryshimin e numrit të parapaguesit, në mënyrë që të sigurohet një cilësi më e mirë dhe mundësi për përdorimin e shërbimeve të reja;
- Inspektimi dhe kontrollimi i rregullshmërisë së pajisjeve dhe instalimeve fundore të parapaguesit.
- Pasi që operatorët nuk prodhojnë ndonjë përmbajtje, operatori nuk duhet që të mbahet përgjegjës për përgjegjësinë redaktuese.

## **NENI 8 - OBLIGIMET LIDHUR ME SHPËRNDARJEN E SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO-VIZUELE DHE SHËRBIMEVE RADIO MEDIALE**

Neni 8 përcakton një detyrim të modifikuar për bartjen e detyrueshme për të gjitha shërbimet mediale audio-vizuale dhe shërbimeve radio mediale, dhe kjo nuk është e pranueshme për operatorët e rrjetit. Duke pasur parasysh se numri i televizioneve dhe radiove në Kosovë është më i madh se 100 (njëqind), detyrimi për të bartur të gjithë prej tyre në platformën e operatorit kabllor nuk është teknikisht i realizueshëm për një operator të rrjetit. Përndryshe, operatorët e rrjetit do të përfundojnë duke transmetuar vetëm përmbajtje lokale dhe nuk do të jenë në gjendje për të plotësuar kërkesën e përdoruesve për përmbajtje të pasur dhe gjithashtu nuk do të jenë në gjendje për të përmbushur objektivat e tyre komerciale.

Prandaj, IPKO kërkon të shlyhet Neni 8.1 dhe 8.3 dhe të ndryshohet Neni 8.2 si vijon:

*“Çdo ofrues i shërbimeve mediale audio-vizuale dhe shërbimeve radio mediale ka të drejtë për trajtim të barabartë në të njëjtat kushte në lidhje me shpërndarjen, në varësi nga interesi komercial dhe kapaciteti teknik i operatorit të rrjetit, duke përjashtuar subjektet që dalin nga paragrafët (1) dhe (2) të Nenit 12”*

## **NENI 12 - OBLIGIMET E SHPËRNDARJES SË PROGRAMIT PËR TRANSMETUESIT E SHËRBIMIT PUBLIK**

***Paragraph 3** - “Operatorët e rrjetit duhet të bartin çdo stacion transmetues tokësor (Radio apo TV) të licencuar në Kosovë që kërkon të transmetohet, me kusht që stacioni i tillë të bartë koston e shërbimeve teknike të transmetimit të sinjalit të tij në operatorin e rrjetit për shpërndarje të mëtejshme.”*

Detyrimi për të përfshirë të gjitha televizionet tokësore dhe radiot në një operatorit të rrjetit është një barrë e madhe për këtë të fundit, në aspektin komercial dhe teknik, edhe nëse transmetuesi i tillë do të mbulojë shpenzimet për transmetimin e sinjalit të tij në platformën e operatorit të rrjetit. Sidomos me numrin e lartë të subjekteve transmetuese të licencuara në Kosovë, dhe rritjen e këtij numri që digjitalizimi i sinjalit në Kosovë do të sjellë.

KPM-ja duhet të marrë parasysh kuadrin rregullator evropian për këtë çështje të veçantë, respektivisht, Direktivën e BE-së mbi Shërbimet universale (2002/22/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për shërbimet universale dhe të drejtat e përdoruesve në lidhje me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike) , e cila në nenin 31, në mënyrë eksplicite thekson se **detyrimi për bartje i nënshtrohet pagesës nga transmetuesit tokësor**, e cila pagesë duhet të jetë proporcionale dhe transparente.

Për më tepër, gjatë hartimit të kësaj projekt Rregulloreje, KPM-ja nuk ka miratuar praktikat më të mira të rregullimit të kësaj çështjeje të veçantë nga Rregullatorët e sektorit të transmetimit jashtë Kosovës. Nëse marrim Mbretërinë e Bashkuar si një shembull, ne mund të shohim se operatorët kabllor në Britani të Madhe janë të detyruar për të bartur vetëm kanalet e mëposhtme: BBC1 dhe 2, ITV, Channel 4 dhe Channel 5.

Prandaj, pozita e IPKO-s në këtë drejtim mbetet e njëjtë si e deklaruar disa herë që nga momenti kur është pajisur me licencë për Distribuim Kabllor. IPKO fuqimisht nuk pajtohet me detyrimin për të bartur të gjitha televizionet tokësore dhe radiot në platformën e vet, duke qenë se bartja e kërkuar i një numri të madh të transmetuesve tokësorë do të konsumojnë kapacitetet e pakta dhe do të zhvendosë përdorimet tjera nga operatorët kabllor të tilla si zgjerimi i kapaciteteve tona të brezit të gjerë (broadband). Është qëndrimi ynë i fuqishëm se ky detyrim duhet të hiqet nga KPM-ja, ose të mbetet vetëm në lidhje me transmetuesin publik.

## **Neni 13 - KËRKESAT OPERACIONALE PËR TË LICENCUARIT E OPERATORËVE TË RRJETIT**

Paragrafi dy (të riformulohet) si:



*“Në rast të një ndërprerje të përkohshme të linjës së parapaguesit, nga trafiku, për shkak të ndërprerjeve të linjës, operatori do të kompensojë parapaguesin për ato ditë kur linja nuk ka qenë funksionale, në rast se ndërprerja është më e gjatë se 48 orë.”*

**Të shtohet:** *“Operatorët e rrjetit nuk do të jenë përgjegjës për defekte në funksionimin e shërbimit, që ka të ngjarë të jenë rezultat i ndërhyrjeve individuale ose të pakoordinuara të parapaguesit. Gjithashtu, operatorët e rrjetit rezervojnë të drejtën të ndërpresin ofrimin e shërbimit për arsye të mirëmbajtjes, përmirësimit, modernizimit, apo optimizimit të rrjetit. Këto ndërprerje mund të zgjasin për aq kohë sa zgjat kryerja e punimeve”*

#### **NENI 14 - KONTRATA E PARAPAGIMIT DHE TARIFA PËR SHËRBIME**

**Paragrafi 3 parasheh** - *“I licencuari është i detyruar të informojë parapaguesit me shkrim, mbi ndryshimet e ardhshme në tarifat dhe kushtet e ofrimit të shërbimeve, minimum 30 ditë më herët. Ky njoftim mund të jetë si një pjesë përbërëse e faturës të lëshuar parapaguesit për shërbimin e ofruar.”*

*“Ky njoftim mund të jetë si një pjesë përbërëse e faturës të lëshuar parapaguesit për shërbimin e ofruar”* kjo mund të jetë e aplikueshme vetëm për parapaguesit biznes, por jo edhe për ata rezidencial, për shkak se lista e çmimeve të shërbimeve të ofruara nga operatorët kabllorë është publike dhe parapaguesit parapaguhen/paguajnë paraprakisht për shërbime të tilla. Prandaj, ne propozojmë që neni të ndryshohet si në vijim:

*“I licencuari është i detyruar të informojë parapaguesin me shkrim, mbi ndryshimet e ardhshme në tarifat dhe kushtet e ofrimit të shërbimeve. Informimi i tillë duhet të bëhet nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të operatorit të rrjetit, dhe numrit të telefonit të kujdesit për konsumatorë i cili do të jetë aktiv 24/7. Ky njoftim mund të jetë si një pjesë përbërëse e faturës të lëshuar për shërbimin e ofruar për parapaguesit biznes”*

#### **NENI 15 - KËSHILLI PROGRAMOR I OPERATORËVE TË RRJETIT**

IPKO propozon të hiqet neni 15 pasi që neni i njëjtë ishte i pranishëm në Rregulloren e Distributimit Kabllor dhe praktika në 5 vitet e fundit ka treguar se ai nuk është zbatuar dhe nuk është i nevojshëm për funksionimin e duhur të operatorit të rrjetit.

## **NENI 17 – KËRKESAT PËR OPERATORËT E RRJETIT DHE OFRUESIT E SHËRBIMEVE PROGRAMORE SI PRODHUES TË PËRMBAJTJEVE PROGRAMORE**

*Paragrafi 5 parasheh:“ Ofruesi i shërbimit të rrjetit, i cili mbulon më shumë se 30% të komunave në Republikën e Kosovës, obligohet t’i sigurojë KPM-së qasje pa kompensim në secilin program me qëllim të monitorimit nga ana e KPM-së”.*

Ky paragraf nuk është i pranueshëm, pasi që i detyron operatorët e mëdhenj të rrjetit për të ofruar shërbim falas për KPM-në pa asnjë bazë ligjore. Rregullorja duhet të promovojë bashkëpunimin mes operatorëve të rrjetit dhe KPM-së në mënyrë që ky i fundit të monitorojë dhe të mbikëqyr tregun transmetues në Kosovë, megjithatë, ajo nuk mund të detyrojë ata për të ofruar qasje të lirë në shërbimet e tyre.

## **NENI 19 – E DREJTA E KPM-SË PËR RAPORTE DHE INSPEKTIVE**

*Pika 1 e këtij neni të ndryshohet pasi neni 3.3 nuk ekziston në Ligjin për KPM-në.*